



## → Shqipëria

### Rreziku i katastrofave ose konflikteve

Shqipëria ndodhet në një rajon rajon sizmik dhe goditet rregullisht nga tërmete të vogla. Vendi është i prirur drejt një numri të madh e të ndryshëm rreziqesh natyrore - duke përfshirë përmbytjet, zjarret në pyje, tërmetet dhe stuhitë e borës. Në vitet e fundit, vendi ka përjetuar emergjenca të shkallës së mesme dhe të lartë, përfshirë këtu përmbytjet në shkurt të vitit 2015 në zonat jugore të Shqipërisë që kanë shkaktuar dëme të rënda në infrastrukture dhe gjënë e gjallë .

### Përgatitja për emergjencat: gatishmëria për të siguruar shërbime prioritare të shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR)

Shqipëria është e pajisur me një kornizë ligjore për menaxhimin e katastrofave, me rolin drejtues të luajtur nga Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (DPEC). Për sektorin e shëndetësisë, Platforma e Përgjithshme mbi Menaxhimin e Rrezikut dhe Gatishmërinë për Katastrofat nën Ministria e Shëndetësisë koordinon aktivitetet e menaxhimit të katastrofave.

Është krijuar një grup pune joformal i përbërë nga institucione qeveritare, agjensitë e Kombeve të Bashkuara dhe shoqëria civile, i cili ka kryer Vlerësimin e Gatishmërisë së MISP në vitin 2014 .

### Gatishmëria e MISP

#### Vlerësimi 2014: Pikat kryesore

Shqipëria mund të rrisë gatishmërinë e saj për të ofruar shërbime prioritare ShSR, bazuar në angazhimin e partnerëve kryesorë kombëtarë të ShSR dhe aktorëve të rrejtimit mjekësor dhe jo-mjekësor të përfshirë në ShSR në mjedise normale, për të siguruar zbatimin e Shërbimeve prioritare të ShSR që në fillim të një krize.

**Arritjet e vërejtura** përfshijnë ekzistencën e strukturave koordinuese dhe politikave që lidhen me katastrofat shëndetësore. Vlerësimi gjithashtu theksoi integrimin e shërbimeve prioritare shëndetësore për nënat dhe foshnjat në planin e emergjencave, si edhe ekzistencën e Strategjisë Kombëtare për parandalimin dhe kontrollin e HIV / AIDS që krijon një mjedis të favorshëm për sigurimin e shërbimeve që lidhen me HIV dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme në situata krize.

**Mangësitë që ende duhet të adresohen** përfshijnë mungesën e integritit të shërbimeve të tjera prioritare të shëndetit seksual dhe riprodhues që janë pjesë e MISP (p.sh. parandalimi dhe trajtimi i HIV-it dhe IST; parandalimi i dhunës seksuale dhe kujdesi për të mbijetuarit); nevoja për të përmirësuar përputhshmërinë e shërbimeve të planifikuara me udhëzimet dhe protokollet ndërkombëtare; dhe mungesa e një grupi formal pune të ShSR për të ndërvepruar me strukturat që merren me koordinimin e shëndetit dhe katastrofave.

## GATISHMËRIA MISP: TË JESH I PËRGATITUR KUR GODET KATASTROFA

Paketa e Shërbimeve Minimum Fillestare (MISP) për shëndetin riprodhues është një sërë aktivitetesh prioritare për të shpëtuar jetë, që duhet të realizohen në fillim të çdo krizë humanitare. Në vitin 2013, Grupi i

Punës Ndërinstitucional për shëndetin riprodhues në situatë të emergjencës humanitare në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore ka zhvilluar një instrument vlerësimi, me 38 tregues, për të matur gatishmërinë në nivel

kombëtar. Instrumenti u aplikua në vitin 2014 si pjesë e një vlerësimi më të gjerë në të gjithë rajonin për të parë sa të përgatitur janë vendet për të adresuar nevojat e shëndetit riprodhues në raste emergjencash.





**OBJEKTIVI 1 I MISP**

**Sistemi i menaxhimit të katastrofave**

**SHPËRNDARJA E TREGUESVE**



19% I REALIZUAR  
19% I REALIZUAR PJESËRISHT  
62% I PAREALIZUAR

- Sistemi i menaxhimit të katastrofave dhe koordinimi shëndetësor i ngritur
- Decentralizim i mirë

- Nuk ka grup pune të SHR të formalizuar
- Integrim i kufizuar i shërbimeve<sup>4</sup> prioritare të shëndetit seksual dhe riprodhues në planet shëndetësore për emergjencat

**VLERËSIMI**



I kufizuar

**OBJEKTIVI 2 I MISP**

**Parandalimi i dhunës seksuale dhe ndihma për të mbijetuarit**

**SHPËRNDARJA E TREGUESVE**



14% I REALIZUAR PJESËRISHT  
86% I PAREALIZUAR

- Njohuri e mirë midis aktorëve kyç të strukturave mjekësore ekzistuese të përfshira në dhënien e shërbimeve për të mbijetuarit e dhunës seksuale

- Nuk ka shërbime të integruara për të mbijetuarit e dhunës seksuale në planet shëndetësore për emergjencat
- Nuk ka informacion për aktorët jomjekësorë të përfshirë në parandalimin e dhunës seksuale dhe në mbështetjen psiko-sociale

**VLERËSIMI**



I kufizuar

**OBJEKTIVI 3 I MISP**

**Reduktimi i transetimit të HIV dhe plotësimi i nevojave të IST**

**SHPËRNDARJA E TREGUESVE**



14% I REALIZUAR  
57% I REALIZUAR PJESËRISHT  
29% I PAREALIZUAR

- Njohuri e mirë e strukturave mjekësore që japin shërbime lidhur me HIV dhe infeksionet seksualisht të tranmetueshme (pa përfshirë parandalimin e transferimit të HIV nga nëna te fëmija)

- Shërbimet prioritare për HIV dhe IST nuk janë të përfshira në planet shëndetësore për emergjencat / Platformën e Ministrisë së Shëndetësisë mbi Menaxhimin e Riskut dhe katastrofave

**VLERËSIMI**



I pranueshëm

- Ka fletëpalosje informuese mbi prezervativët

**OBJEKTIVI 4 I MISP**

**Parandalimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare dhe foshnjore**

**SHPËRNDARJA E TREGUESVE**



43% I REALIZUAR  
57% I REALIZUAR PJESËRISHT

- Të kuptuarit si duhet e shërbimeve të planifikuara në planin shëndetësor për emergjencat

- Përpunueshmëri e moderuar e shërbimeve të planifikuara me standartet minimum të pranuar ndërkombëtarisht

**VLERËSIMI**



I mirë

- Njohuri e avancuar midis aktorëve kyç për strukturat ekzistuese që japin shërbime për nënat dhe foshnjat

- Instrumenta monitorues të pamjaftueshëm

**PËRMIRËSIMI I GADISHMËRISË PËR TË DHËNË SHËRBIME SHSR QË SHPËTOJNË JETË**

Adreson formalizimin e Grupit të Punës të ShSR në përgatitje dhe në përgjigje të emergjencave (Grupi i Punës ShSR i ngritur); fokusohet në forcimin e kapaciteteve të Grupit kombëtar të Punës ShSR dhe ekspertëve teknikë (u ndërmor trajnimi MISP me një audiencë të gjerë).

**Rekomandime për Planin e Veprimit 2016 e më tej**

- Të vazhdohen përpjekjet e filluara në vitin 2015 për të ngritur plotësisht Grupin e Punës ShSR, të zhvillohen Termat e Referencës dhe të sqarohen lidhjet e tij me strukturat koordinuese shëndetësore dhe të emergjencave.
- Të adresohen boshllëqet në gadishmërinë MISP, të theksuara në rezultatet e vlerësimit, përmes rishikimit të planit shëndetësor në emergjencat për të integruar plotësisht të gjitha shërbimet prioritare ShSR të përshkruara në MISP;
- Të përforcohet fuqia punëtore ShSR përmes trajnimeve MISP dhe avokimit për integrimin e MISP në kurrikulumet akademike;
- Të përmirësohet gatishmëria në monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave (MISP Listë e plotë, rishikimi i treguesve ShSR të integruar në Sistemin e Informacionit Shëndetësor).

1. Projekti Shqiptar i zbutjes së riskut nga katastrofat  
2. Vlerësim i kryer në 2014 nga: Ministria e Shëndetësisë, Fondi i Sigurimit Shëndetësor, Institutit i Shëndetit Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, Kryqi i Kuq Shqiptar, CARITAS-i Shqiptar, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (anëtar i IPPF) dhe UNFPA  
3. Rezultatet e vlerësimit të gatishmërisë MISP  
4. Shërbime prioritare në këtë dokument i referohet shërbimeve të përshkruara në Paketën e Shërbimeve Minimum Filltare për Shëndetin Riprodhues në Kriza Humanitare (MISP)  
5. Dmth plani kombëtar i sektorit shëndetësor për emergjencat civile

PËR REFERENCA TË PLOTA, JU LUTEM VIZITONI <http://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SWOP-complete.pdf>

